

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6206
E mërkurë, 6 janar 2021
çmimi 0.40

Kuvendi voton për dërgimin e FSK-së në misione paqeruajtëse

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ZAFIR BERISHA ■ FAQE 4-5



NISMA, 99.9 PËR QIND DO TË SHKOJË E VETME NË ZGJEDHJE

Anëtari i kryesisë së Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, ka bërë me dije se kjo parti nuk pritet të bëjë ndonjë koalicion parazgjedor me partitë e mëdha në zgjedhjet e parakohshme

parlamentare. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se në bazë të zhvillimeve të fundit kjo parti 99.9 për qind do të shkojë e vetme në zgjedhje. Sipas tij, bazuar në të dhënat që kanë nga

terreni, Nisma do të marrë rreth 55 mijë vota apo 8 deri në 9 deputetë. Berisha ka vlerësuar se kjo parti do të jetë determinuese e zhvillimeve politike dhe institucionale pas zgjedhjeve të reja

OPINION

SHPËRFAQJA E (DE)FEKTEVE TË VAKSINËS NË KOSOVË F. 11

Nga Mehmet PRISHTINA



AKTUALE



HOXHAJ PËR LUGINËN E PRESHEVËS: DY VENDE NË LISTËN PËR DEPUTETË DHE NËNSHTETËSI TË KOSOVËS F. 3

KOSOVA SIGURON 500 000 VAKSINA KUNDËR COVIDIT F. 3



EKONOMI

KOSOVA NË VENDIN E DYTË PËR ÇMIMIN MË TË LIRË TË RRYMËS NË EVROPË F. 8

HOTELIERËT E KOSOVËS: SA MË PARË TË HIQEN KUFIZIMET F. 8

SPORT

THAQI: BALLKANI RRËMBEN TITULLIN OSE KUPËN F. 12

DY PËRBALLJE INTERESANTE NË BASKETBOLL F. 12

SHPËRTHEN BOMBOLA E GAZIT NË NJËRIN NGA RESTORANTET NË KOMPLEKSIN "VILLAGE" NË FERIZAJ ■ FAQE 6

42 TË LËNDUAR NGA SHPËRTHIMI I BOMBOLËS SË GAZIT NË FERIZAJ

Numri i të lënduarve nga shpërthimi i bombolës së gazit në një lokal gastronomie në Ferizaj ka shkuar në 42. Katërmbëdhjetë të lënduar po trajtohen në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë. Tre prej tyre janë në gjendje të rëndë. Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, pas këtij shpërthimi ka dalë në vendin e ngjarjes, pastaj ka vizituar të lënduarit në spital. Aliu ka thënë se pamjet nga ky shpërthim janë të tmerrshme



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOV.
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Xhorxhia e ShBA-së voton në balotazhin për senator

NJU-JORK, 5 JANAR - Në shtetin amerikan të Xhorxhias nisi votimi në balotazhin për senatorë, që do të vendosë nëse demokratët e presidentit të zgjedhur Joe Biden do ta kontrollojnë Senatin ose jo. Partisë së Bidenit i duhet t'i fitojë të dyja ulëset për ta marrë kontrollin e plotë të Kongresit dhe, me të, fuqinë për të shtyrë përpara agjendën e tij. Partia Republikane e presidentit në largim, Donald Trump, ka nevojë vetëm edhe për një

ulëse, për ta ruajtur kontrollin në Senat.

Bideni ka thënë se banorët e Xhorxhias mund ta modelojnë ShBA-në për vitet që do të vijnë. Trump, në anën tjetër, u ka thënë votuesve të tij se është "shansi i fundit për ta shpëtuar Amerikën" që duan. Republikanët Kelly Loeffler dhe David Perdue aktualisht mbajnë dy vendet e Xhorxhias në Senat.

Loeffler konkurren kundër demokratit Reverend Raphael

Warnock, ndërsa Perdue kundër Jon Ossoffit. Asnjëri prej kandidatëve nuk ka siguruar 50-përqindëshin e nevojshëm të votave në zgjedhjet e nëntorit, gjë që ka çuar në balotazhin e sotëm. Republikanët aktualisht kanë 52 nga 100 vendet e Senatit. Nëse demokratët fitojnë të martën, Senati do të ndahet në mënyrë të barabartë. Në atë rast, votë përcaktuese në Senat do të jetë ajo e nënpresidentit të ardhshme demokrate Kamala Harris.



'BioNTech' paralajmëron kundër shtyrjes së dozës së dytë të vaksinës



BERLIN, 5 JANAR - Kompania farmaceutike gjermane "BioNTech" ka njoftuar se nuk ka të dhëna që mbështesin "sigurinë dhe efikasitetin" e vaksinës kundër koronavirusit, nëse doza e dytë shtyhet më shumë se tri javë. "BioNTech", që ka zhvilluar vaksinën së bashku me kompaninë amerikane "Pfizer", tha se të dhënat klinike që tregojnë se efikasiteti i vaksinës është 95 për qind, bazohen në dhënien e dy dozave me një diferencë

kohore prej tri javësh. "Siguria dhe efikasiteti i vaksinës nuk janë vlerësuar në orare të tjera dozimi", ka njoftuar "BioNTech".

E përballur me numër të kufizuar vaksinash, Danimarka ka thënë të hënën se dy dozat do t'i ndajë deri në gjashtë javë.

Mbretëria e Bashkuar ka thënë se do të presë deri në 12 javë përpara se ta japë dozën e dytë. Edhe Gjermania është duke e shqyrtuar shtyrjen e

dozës së dytë për më shumë se tri javë.

Mbështetësit e kësaj praktike thonë se ajo do t'u mundësojë më shumë njerëzve të vaksinohen me dozën e parë. "Vendimet për regjimet alternative të dozimit u përkasin autoriteteve shëndetësore, por ne besojmë se doza e dytë nevojitet për të siguruar mbrojtje maksimale kundër sëmundjes", ka njoftuar kompania "BioNTech".

Arabia Saudite po rihap kufijtë me Katarin

RIAD, 5 JANAR - Arabia Saudite po rihap kufijtë e saj tokësorë dhe detarë me Katarin pas më shumë tre vjet mosmarrëveshjeje. "Është arritur një marrëveshje për të hapur hapësirën ajrore dhe kufijtë tokësorë dhe detarë midis Arabisë Saudite dhe Katarit që nga kjo mbrëmje", ka pohuar ministri i Jashtëm i Kuvajtit, Ahmad Nasser al-Sabah.

Masa vjen përpara një takimi të nivelit të lartë të Këshillit të Bashkëpunimit të Gjirit që do të mbahet të martën në

Arabisë Saudite.

Në mes të vitit 2017 Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Bahrejni dhe Egjipti ndërprejnë lidhjet diplomatike, tregtare dhe të udhëtimit me Katarin, duke akuzuar vendin për mbështetjen e terrorizmit, një akuzë që Doha e mohon.

Të katër vendet i bënë presion Katarit për të pranuar 13 kërkesa, duke përfshirë mbylljen e transmetuesit televiziv të lajmeve Al Jazeera, mbylljen e një baze turke, ndërprerjen e lidhjeve me Vëllazërinë Myslimane dhe

prishjen e lidhjeve me Iranin. Shtetet e Bashkuara dhe Kuvajti janë përpjekur të ndihmojnë në dhënien fund të kësaj grindjeje, pasi vlerësojnë se përçarja mes këtyre vendeve do të kundërshtuar Iranin, i cili u akuzua për sulmin ndaj rafinerive saudite të naftës më 2019.

Këshilltari i Lartë i Shtëpisë së Bardhë, Jared Kushner, i dërguari në Lindjen e Mesme Avi Berkowitz dhe Brian Hook, një këshilltar special i Departamentit të Shtetit, do të



marrin pjesë në nënshkrimin e marrëveshjes me Arabinë

Saudite, tha një zyrtar i lartë i administratës Trump.



Presidenti armen diagnostikohet me Covid në Londër

Londër, 5 janar - Presidenti i Armenisë, Armen Sarkisian, u diagnostikua me Covid-19 gjatë një vizite në Londër. Ai udhëtoi atje për një operacion në këmbë, por përjetoi edhe simptoma që lidhen me Covid-19, raportuan të martën agjencitë armene të lajmeve. Sipas tyre, Sarkisian, 67 vjeç,

është vetizolu dhe vazhdon të punojë. Londra është duke përjetuar një rritje të mprehtë të rasteve me Covid.

Kryeministri britanik, Boris Johnson, shpalli të hënën një bllokim të ri për Anglinë, për të frenuar përhapjen e rasteve. Sarkisian i bashkohet një liste të gjatë të liderëve dhe

zyrtarëve botërorë që kanë kontraktuar Covidin, përfshirë këtu Johnsonin dhe presidentin e ShBA-së, Donald Trump. Kryeministri armen, Nikoll Pashinian, ka dalë pozitiv vitin e kaluar. Armenia ka raportuar mbi 160 000 raste me Covid-19 dhe mbi 2,800 viktima.

Hoxhaj për Luginën e Preshevës: Dy vende në listën për deputetë dhe nënshtetësi të Kosovës

Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka bërë me dije të martën se ky subjekt politik do të përfshijë në listën e saj për deputetë dy përfaqësues nga Lugina e Preshevës si dhe do ta nisë iniciativën që shqiptarët e Luginës së Preshevës të pajisen me letërnjoftimin dhe pasaportën e Republikës së Kosovës



Shtatë zotimet e PDK-së për Luginën

1. PDK-ja do të përfshijë në listën e saj për deputetë dy përfaqësues nga Lugina e Preshevës që e përfaqësojnë secilën komunë të Luginës, ashtu që zëri i shqiptarëve të Luginës së Preshevës të dëgjohet në Kuvendin e Kosovës.
2. PDK-ja do ta iniciojë Ligjin për mbështetjen e shqiptarëve në Luginën e Preshevës që do të garantonte zotimet ligjore të Qeverisë së Kosovës për shqiptarët e Luginës duke krijuar strukturat e nevojshme, duke siguruar mbështetje financiare dhe mbështetje për zhvillimin arsimor, kulturor dhe shoqëror.
3. PDK-ja dhe qeveria e udhëhequr nga PDK-ja do ta themelojë Agjencinë Shtetërore për Luginën e Preshevës si organ koordinues i Kosovës për adresimin e sfidave të shqiptarëve të Luginës dhe për koordinimin e ndihmës shtetërore të Kosovës. Kjo Agjenci do të jetë nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të kryeministrit të Kosovës.
4. PDK-ja do të marrë iniciativën që shqiptarët e Luginës së Preshevës të pajisen me letërnjoftimin dhe pasaportën e Republikës së Kosovës. Kjo do të realizohet përmes nismës së PDK-së për ta amendamentuar Ligjin për Shtetësinë e Kosovës.
5. PDK-ja do ta ndër marrë rritjen e kuotave për studentët nga Lugina dhe krijimin e kuotave të reja për studentët nga Lugina që ndodhen në Kosovë.
6. PDK-ja dhe qeveria e drejtuar nga PDK-ja do t'i hapë katër pika të reja kufitare me Luginën e Preshevës, ashtu që ta lehtësojë qarkullimin e shqiptarëve të Luginës. Këto pika kufitare do të jenë në këto fshatra të Luginës - Muhoc, Breznicë, Dobrosin dhe Ranatoc.
7. PDK-ja do ta krijojë Fondin e përhershëm për kthimin e shqiptarëve të Luginës të dëbuar nga vatrata e tyre. Ky Fond i Qeverisë së Kosovës do të jetë me vlerë prej 5 milionë eurosh në vit dhe do të orientohet nga zhvillimi ekonomik, kulturor, rural dhe arsimor i Luginës së Preshevës.

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 JANAR - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka mbajtur të martën një konferencë për media përmes së cilës ka dalë me disa zotime publike në lidhje me përfshirjen e Luginës së Preshevës në jetën publike dhe politike të Kosovës. Në këto zotime, ndër të tjera, Hoxhaj ka thënë se PDK-ja do të përfshijë në listën e saj për deputetë dy përfaqësues nga Lugina e Preshevës si dhe do ta nisë iniciativën që shqiptarët e Luginës së Preshevës të pajisen me letërnjoftimin dhe pasaportën e Republikës së Kosovës.

Në shtatë zotimet që ka bërë publike kandidati i PDK-së për kryeministër, përfshihen edhe Ligji për mbështetjen e shqiptarëve në Luginën e Preshevës, themelimi i Agjencisë Shtetërore për Luginën e Preshevës, rritja e kuotave për studentët nga Lugina dhe krijimi i kuotave të reja për studentët e dëbuar nga Lugina që ndodhen në Kosovë, katër pika të reja kufitare me Luginën e Preshevës dhe Fondi i përhershëm për kthimin e shqiptarëve të Luginës të

dëbuar nga vatrata e tyre. “Në javën e kaluar të fundit të 2020-s, pas propozimeve që shpалosëm për diasporën, sot si kryeministër i ardhshëm i Kosovës do të prezantoj para qytetarëve të Kosovës zotimet tona konkrete për një pjesë tjetër të kombit që nuk jeton në Kosovë, por në Luginën e Preshevës, e cila vazhdimisht ka qenë një brengë e madhe për Partinë Demokratike. Si një parti e dalë nga lufta dhe me themele të forta patriotike, gjithmonë ka qenë e përkushtuar që t’ua zgjasë dorën e përkrahjes vëllezërve dhe motrave tona të Luginës së Preshevës. Partia Demokratike në vazhdimësi e ka përcjellë me shqetësim gjendjen e shqiptarëve të Luginës, situatën e rëndë ekonomike të tyre, diskriminimin shtetëror të ushtruar ndaj tyre dhe plagën e emigrimit të shqiptarëve nga vatrata e tyre në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë. Ne nuk jemi një parti populiste që flet për kombin dhe Luginën vetëm për vota, as nuk jemi parti për tregtarë flamujsh që patriotizmin e kanë vetëm për imazh, por PDK-ja gjithmonë, me veprime konkrete, u ka dalë krahë vëllezërve tanë në Luginë”, është shprehur Hoxhaj.

Gent Cakaj dorëzon detyrën e ministrit tek Olta Xhaçka

TIRANË, 5 JANAR (ER) - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme në Shqipëri, Gent Cakaj, i ka dorëzuar detyrën ministres Olta Xhaçka. “Nga dita e sotme nuk do të jem thjesht një paraardhës politik i Oltës, por mbështetësi më i madh i saj, që ajo ta përfaqësoj Shqipërinë denjësisht e me shkëlqim të plotë, me arritje të rralla e paraqitje të fortë në fushën e politikës së jashtme”, ka thënë Cakaj. Ai ka theksuar se mbetet tepër krenar e ballëllartë për të gjitha arritjet e këtyre viteve të fundit, duke filluar nga forcimi i faktorit shqiptar në Ballkanin

Perëndimor, veçanërisht për punën e jashtëzakonshme në Luginën e Preshevës dhe ngritjen e pashembullt të zërit në mbrojtje të interesave të Republikës së Kosovës, vendimi për hapjen e bisedimeve për anëtarësim në BE, kryesia e suksesshme e OSBE-së e deri tek afrimi historik për marrjen e ulëses jo të përhershme në Këshillin e Sigurimit për 2022-2023. “Puna për Shqipërinë, natyrisht, nuk përfundon këtu. Përpjekja ime sot thjesht ndryshoi trajtë. Shqipëria për mua do të mbetet ëndrra që do t’i detyrohem për jetë”, ka pohuar Cakaj.





FLET PËR "EPOKËN E RE", ZAFIR BERISHA

NISMA, 99.9 PËR QIND DO TË SHKOJË E VETME NË ZGJEDHJE

Anëtari i kryesisë i Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, ka bërë me dije se kjo parti nuk pritet të bëjë ndonjë koalicion parazgjedhor me partitë e mëdha në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se në bazë të zhvillimeve të fundit kjo parti 99.9 për qind do të shkojë e vetme në zgjedhje. Sipas tij, bazuar në të dhënat që kanë nga terreni, Nisma do të marrë rreth 55 mijë vota apo 8 deri në 9 deputetë. Berisha ka vlerësuar se kjo parti do të jetë determinuese e zhvillimeve politike dhe institucionale pas zgjedhjeve të reja

zgjedhje, çështja e pragut nuk do të jetë problem. Ai ka bërë me dije se tani Nisma është fokusuar drejt objektivit që synon t'i realizojë në këto zgjedhje. "Bazuar në të gjitha të dhënat që i kemi marrë nga terreni, Nisma ka rreth 55 mijë vota në gjithë Kosovën. Përkthyer në deputetë, i bie që pritet t'i kemi 8 deri në 9 deputetë në legjislaturën e ardhshëm në Kuvendin e Kosovës", ka thënë Berisha.

Ai ka treguar se për koalicion me PDK-në nuk kanë folur pas aktgjykimit të Kushtetueses. Sipas tij, Nisma nuk do ta pretë PDK-në dhe asnjë parti tjetër. "Nuk kemi biseduar tani. Bisedat kanë qenë para vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Pra, kemi biseduar në këtë frymë sepse është ditur që së shpejti do të ketë zgjedhje. Ndërsa tani, siç po shihet, PDK-ja e ka problemin e brendshëm. Pra, e ka një 'humbje të rrugës' brenda oborrit të vet", ka deklaruar Berisha, duke shtuar

se kjo parti do të jetë determinuese e zhvillimeve politike pas zgjedhjeve të reja. "Tani jemi fokusuar te struktura e Nismës dhe tek elektorati i saj për të kontaktuar dhe për t'i shtuar votat e Nismës, në mënyrë që zëri i kësaj partie të jetë i fuqishëm në institucionet e Kosovës. Vetëm kështu Nisma do të jetë determinuese e zhvillimeve politike dhe institucionale pas zgjedhjeve që do të mbahen së shpejti", ka thënë Berisha. Sipas tij, Nisma asnjëherë s'ka qenë më e gatshme për zgjedhje sesa tani. "Nisma Socialdemokrate kurrë më e gatshme për zgjedhje nuk ka qenë. Ne kemi qenë në organizim e sipër të kuvendeve zgjedhore, sepse në bazë të rrethanave politike ne kemi pasur paralajmërim që së shpejti do të shkohet në zgjedhje. Kështu që për ne, zgjedhjet nuk kanë qenë befasi", është shprehur Zafir Berisha.

"Epoka e re": Z. Berisha, shumë shpejt pritet të bëhet publike data e zgjedhjeve. Sa është e gatshme Nisma për këto zgjedhje?

Berisha: Nisma Socialdemokrate kurrë më e gatshme për zgjedhje nuk ka qenë. Ne kemi qenë në organizim e sipër të kuvendeve zgjedhore. Në bazë të rrethanave politike ne kemi pasur paralajmërim që së shpejti do të shkohet në zgjedhje. Kështu që për ne zgjedhjet nuk kanë qenë befasi. Natyrisht se tani na ka dalë angazhim ditor që të takohemi me strukturat. Dhe, në bazë të statistikave brendapartiake, Nisma do të hyjë e përgatitur në këto zgjedhje, edhe nëse ato mbahen brenda 24 orëve.

"Epoka e re": Lidershpi i Nismës ka bërë me dije se synimet e kësaj partie janë që të shkojë në zgjedhje me ndonjë koalicion parazgjedhor. Cilat

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 5 JANAR - Anëtari i kryesisë i Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, ka deklaruar që, sipas të gjitha gjasave, kjo parti do të shkojë e vetme në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të cilat pritet të mbahen në fillim të muajit të ardhshëm. Ai ka thënë se këtë po e determinojnë

zhvillimet e fundit politike.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Berisha ka shprehur optimizëm për rezultatet që do t'i arrijë kjo parti në zgjedhje. "Sipas zhvillimeve që janë duke ndodhur ditët e fundit, Nisma Socialdemokrate 99.9 për qind do të hyjë si subjekt i vetëm në zgjedhje", ka thënë Berisha. Ai është shprehur i bindur se nëse kjo parti shkon e vetme në

janë preferencat e Nismës për koalicion parazgjedhor?

Berisha: Ka pasur ndoshta një keqinterpretim edhe të qëllimshëm nga dikush për këtë çështje. Kryetari Limaj ka qenë dhe vazhdon të jetë i interesuar për një bosht të spektrit politik për t'i përballuar sfidat të cilat i ka Kosova para vetes. Ne kemi parasysh dy sfidat kryesore që kemi si shtet: përballjen me Gjykatën Speciale dhe dialogun me Serbinë. Këto dy tema kërkojnë individë të vendosur dhe të dëshmuar. Në këtë kuptim, z. Limaj ka qenë dhe vazhdon të jetë i interesuar që të ketë një bosht politik i cili hyn me këto synime në zgjedhje. Natyrisht, duke mos i harruar edhe sfidat me të cilat jemi duke jetuar tash e një vit, sidomos kriza ekonomike që ka ardhur si pasojë e pandemisë.

"Epoka e re": Në këtë bosht politik është paraparë edhe PDK-ja?

Berisha: Jo vetëm në PDK, por edhe në parti të tjera ka individë të cilët kanë dëshmuar veten se janë të gatshëm për t'i dhanë edhe më tej Kosovës, pra në raport me disa individë që as një punë të vetme nuk e kanë kryer për Kosovën. Në fakt, ata janë qiraxhi në shtetin e Kosovës dhe të cilët tentojnë ta përfaqësojnë Kosovën në këto sfida të rëndësishme.

"Epoka e re": A e keni diskutuar me PDK-në këtë çështje dhe cilat janë gjasat që të ndodhë një koalicion i tillë?

Berisha: Nuk kemi biseduar tani. Bisedat kanë qenë para vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Pra, kemi biseduar në këtë frymë sepse

është ditur që së shpejti do të ketë zgjedhje. Ndërsa tani, siç po shihet, PDK-ja e ka problemin e brendshëm. Pra, e ka një 'humbje të rrugës' brenda oborrit të vet. Ne nuk merremi me këto çështje sepse janë probleme të tyre. Tani jemi fokusuar te struktura e Nismës dhe tek elektorati i saj për të kontaktuar dhe për t'i shtuar votat e Nismës, në mënyrë që zëri i kësaj partie të jetë i fuqishëm në institucionet e Kosovës. Vetëm kështu Nisma do të jetë determinuese e zhvillimeve politike dhe institucionale pas zgjedhjeve që do të mbahen së shpejti.

"Epoka e re": Po me LDK-në, mund të ketë ndonjë koalicion, nëse me PDK-në nuk bëni?

Berisha: Rrugëtimi i LDK-së me gjasë është i ndarë dhe nuk besoj se duhet të humbim kohë të mendojmë në atë drejtim. Sipas zhvillimeve që janë duke ndodhur ditët e fundit, Nisma Socialdemokrate 99.9 për qind do të hyjë si subjekt i vetëm në zgjedhje.

"Epoka e re": Nëse do të hyni të vetëm në zgjedhje, do ta keni problem kalimin e pragut zgjedhor?

Berisha: Pas analizave që i kemi bërë, çështja e pragut nuk është problem për Nismën. Ne jemi fokusuar drejt objektivit tonë që synojmë ta realizojmë në këto zgjedhje.

"Epoka e re": Cili është ky objektiv?

Berisha: Bazuar në të gjitha të dhënat që kemi marrë nga terreni, Nisma ka rreth 55 mijë vota në gjithë Kosovën. Përkthyer në deputetë, i bie që pritet t'i kemi 8 deri 9 deputetë në legjislaturën e ardhshme në Kuvendin e Kosovës.

Kuvendi voton për dërgimin e FSK-së në misione paqeruajtëse

Kuvendi i Kosovës votoi të martën për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) jashtë vendit. Me 92 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, deputetët dhanë miratimin për dërgimin e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në misione paqeruajtëse, në kuadër të Forcës Kombëtare të shtetit amerikan të Ajovës

PRISHTINË, 5 MAJ- Me 92 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i Republikës së Kosovës vendosi për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) jashtë vendit, me mision ofrimin e mbështetjes për stabilitet rajonal dhe operacione paqeruajtëse, në regjionin e komandës qendrore amerikane.

"Përparimi i vazhdueshëm në aspektin operacional dhe profesional i Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe përkushtimi i jashtëzakonshëm i vajzave dhe djemve tanë, kanë bërë që FSK-ja të fitojë besimin e partnerit tonë kryesor strategjik, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të qenë krah forcave paqeruajtëse amerikane në misione ndërkombëtare paqeruajtëse", ka thënë kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, në fjalimin e tij përpara Kuvendit të Kosovës.

Seanca e jashtëzakonshme u mbajt me kërkesë të Hotit.

Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, tha se ky votim është i natyrës historike, por gjithashtu, siç tha ajo, është edhe krenari e dyfishtë, së pari



me djemtë dhe vajzat e FSK-së, të cilët kanë arritur këtu si rezultat i shumë brezave, por gjithashtu është edhe krenari, për shkak se kjo arritje po bëhet së bashku me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Jam vërtet e lumtur që si Kuvend i Republikës së Kosovës po e përmbysim këtë legjislaturë me një vendim të tillë dhe po ashtu jam e bindur se ky është vetëm fillimi për sukseset e ushtrisë sonë", ka theksuar Osmani. Më 31 dhjetor të vitit të kaluar, Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për dërgimin e kontingjentit të Forcës së

Sigurisë së Kosovës në misione jashtë vendit me Gardën Kombëtare të Ajovës. Ky vendim më pas i është dërguar Kuvendit të Kosovës. FSK-ja, deri më tani, nuk ka marrë pjesë në operacione paqeruajtëse jashtë vendit. Në vitin 2018, Kuvendi i Kosovës ka miratuar ndryshimet ligjore për transformimin e mandatit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në forca të armatosura. Sipas legjislacionit, është paraparë që procesi i transformimit në Ushtrinë e Kosovës të zgjasë dhjetë vjet.

Limaj në Mitrovicë: Vendit po i kanoset një e keqe e madhe

MITROVICË, 5 JANAR (ER)- Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka takuar strukturat drejtuese të degës së Nismës në Mitrovicë, nga të cilët ka kërkuar mobilizim për zgjedhjet e parakohshme nacionale të cilat pritet të mbahen muajin shkurt. Kreu i Nismës ka thënë se vendi po i kanoset një e keqe e madh. Ai ka ftuar përkrahësit e tij në Mitrovicë që të ngritën në këmbë dhe të mos lejojnë dëmtimin e vendit. Limaj ka thënë se është një moment i veçantë dhe duhet pasur kujdes që mos lejojmë të biem pre e një mashtrimit të madh

që po i përgatitet vendit. "Apeli im është. Këto ditë që po na vijjnë t'i shtoni përpjekjet dhe ta rrisim angazhimin e përbashkët në shërbim të vendit. Themelet e shtetit dhe vlerat tona po cenohen. Në zgjedhjet e kaluara kemi thënë bashkë për shtetin dhe tani po angazhohemi në mbrojtje të shtetit dhe vlerave kombëtare. Ne, qysh para tri viteve kemi paralajmëruar se Kosova do të jetë në një udhëkryq të madh dhe tani jemi në atë moment", ka thënë ndër të tjera Limaj në Mitrovicë.

Ai ka thënë se nëse Kosova



merr drejtimin e gabuar, atëherë mund të bëhet dëm i riparueshëm. "Në politikë ka gabime që mund të riparohen por ka edhe që s'mund të parashikohen. Një nga to është Gjykata Speciale. Ne nuk e kemi votuar Gjykatën Speciale dhe kemi paralajmëruar se sa keq është. Rreshtimi dhe vendimi politik është shumë i rëndësishëm. Nuk mjafton të jesh në rrugë të drejtë dhe të dëmtohet vendi", ka shtuar ai.

Lideri i Nismës ka thënë se këto zgjedhje nuk janë për Nismën e për të personalisht, por janë betejë për vendin.

Shpërthen bombola e gazit në njërin nga restorantet në kompleksin "Village" në Ferizaj

42 të lënduar nga shpërthimi i bombolës së gazit në Ferizaj

Numri i të lënduarve nga shpërthimi i bombolës së gazit në një lokal gastronomie në Ferizaj ka shkuar në 42. Katërmbëdhjetë të lënduar po trajtohen në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë. Tre prej tyre janë në gjendje të rëndë. Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, pas këtij shpërthimi ka dalë në vendin e ngjarjes, pastaj ka vizituar në spital të lënduarit. Aliu ka thënë se pamjet nga ky shpërthim janë të tmerrshme



EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

FERIZAJ, 5 JANAR - Dyzet e dy persona u lënduan të martën nga shpërthimi i një bombole gazi në Ferizaj. Katërmbëdhjetë prej tyre po trajtohen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, tre prej tyre janë në

gjendje më të rëndë. "Ka ndodhur një shpërthim i një bombole gazi në një restorant. Ka mjaft të lënduar dhe dëme materiale. Dyzet e dy persona janë të lënduar", ka thënë Qazim Reka, zyra për media i Policisë së Kosovës në Ferizaj. Shkaqet e shpërthimit nuk dihen ende.

Doktor Agron Çitaku ka bërë

me dije se pesë nga të pranuarit janë në sallën e operacionit dhe katër të tjerë po presin të hyjnë në operim, kurse një është dërguar në Klinikën e Ortopedisë. Ai ka thënë se gjendja e tyre është mesatarisht e rëndë.

Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka reaguar në lidhje me këtë shpërthim. "Të tmerrshme pamjet nga shpërthimi i fuqishëm i pasdites së sotme në njërin nga restorantet në kompleksin 'Village' në Ferizaj. Ekipet emergjente komunale, si zjarrfikësit, ekipet e

emergjencës shëndetësore, policia dhe kompetentët e tjerë dolën menjëherë në vendngjarje. Uroj të mos shënohet asnjë viktimë. Gjatë vizitës që u bëra, u urova shërim të shpejtë gjithë të lënduarve. Faleminderit mjekëve dhe infermierëve të QKMF-së dhe Spitalit të Përgjithshëm që me përpjekje mbinjerëzore po japin gjithçka nga vetja për ta mbrojtur shëndetin e të lënduarve", ka thënë Aliu, i cili ka dalë në vendin e ngjarjes. Kryetari Aliu ka vizituar edhe të lënduarit në spital.

Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka reaguar pas këtij shpërthimi, duke theksuar se MPB-ja dhe agjencitë e saj do të vazhdojnë t'u dalin në ndihmë qytetarëve në çdo rrethanë. "Me shqetësim të madh pranova lajmin rreth incidentit që ndodhi sot në një qendër tregtare në Ferizaj. Lajmet e tilla në këtë fillim vit na shqetësojnë tej mase andaj me këtë rast shpreh keqardhjen time, njëkohësisht i dëshiroj shërim sa më të shpejtë të lënduarve. Ky rast, edhe rastet e tjera, e ngrehin nevojën e kujdesit sa më të madh dhe ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për rrethimet që na rrethojnë. Ministria e Punëve të Brendshme me agjencitë e saj do të vazhdojnë t'u dalin në ndihmë qytetarëve të saj pa dallim në çdo rrethanë, duke u ofruar përkujdesje dhe siguri", ka thënë ministri Veliu.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, u ka uruar shërim të shpejtë personave të lënduar gjatë shpërthimit në Ferizaj. "Lutjet tona janë për të prekurit dhe të plagosurit e shpërthimit që ndodhi sot në Ferizaj. Ndajmë shqetësimin me familjarët dhe ju urojmë shërim të shpejtë të gjithë të lënduarve", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Asamblisti i Nismës aderon në AAK

PRISHTINË, 5 JANAR - Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Haxhi Shala, ka bërë me dije se asamblisti i Nismës Socialdemokrate në Drenas, Vehbi Berisha, ka aderuar në AAK. "Fuqishëm, rrugëtimit tonë politik në

Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i është bashkuar edhe asamblisti dhe nënkryetari i degës së Nismës Socialdemokrate në Drenas, Vehbi Berisha. Vehbiu ka qenë asamblist në Kuvendin Komunal të Drenasit për dy

mandate. Në mandatin e fundit ka qenë i angazhuar në parti dhe lartpërmendur. Nga sot Vehbiu e ka shprehur vullnetin që rrugëtimit politik ta vazhdojë me AAK-në", ka shkruar Shala në llogarinë e vet në "Facebook".



Kosova siguron 500 000 vaksina kundër Covidit

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se Republika e Kosovës ka siguruar 500 000 vaksina kundër Covidit nga kompania farmaceutike "Pfizer". Ai ka thënë se konfirmimin për sigurimin e këtyre vaksinave e kanë dhënë përfaqësuesit e "Pfizer"-it gjatë një takimi virtual të mbajtur të martën. Gjatë 24 orëve të fundit janë konfirmuar edhe 199 raste të reja me Covid në Kosovë, gjithashtu si pasojë e këtij virusi kanë vdekur edhe katër pacientë



Gjatë 24 orëve 430 të shëruar dhe 199 raste të reja me Covid

Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 282 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 199 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar edhe katër raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prishtinë dy raste

(78, 66 vjeç), Malishevë një rast (79 vjeç), Prizren një rast (79 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 52 333 raste nga 189 420 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 355 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 430 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 43 378 raste, kurse numri i rasteve aktive është 7 600. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 87 raste, Pejë 17 raste, Ferizaj 16 raste, Podujevë 16 raste, Lipjan 12 raste, Fushë-Kosovë 7 raste,

Gjilan 6 raste, Shtime 5 raste, Deçan 4 raste, Gjakovë 4 raste, Obiliq 4 raste, Prizren 4 raste, Drenas 3 raste, Malishevë 3 raste, Vushtrri 3 raste, Junik 2 raste, Kamenicë 2 raste, Suharekë 2 raste dhe me nga një rast komunat Istog dhe Rahovec. Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që të vijnë të testohen për Covid-19 sipas indikacioneve epidemiologjike, në të gjitha qendrat rajonale të shëndetësisë publike në Kosovë.

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 5 JANAR - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije të martën se Republika e Kosovës ka siguruar 500 000 vaksina kundër Covidit nga "Pfizer". "Në kuadër të angazhimeve konkrete për sigurimin e vaksinave kundër Covid-19, dëshiroj të ndaj me qytetarët informata se kemi siguruar 500 000 vaksina kundër kësaj sëmundje nga kompania 'Pfizer'. Konfirmimin për sigurimin e këtyre vaksinave na e kanë dhënë përfaqësuesit e 'Pfizer'-it gjatë një takimi virtual të mbajtur sot me ta", ka thënë Zemaj. Ai ka theksuar se MSh-ja ka qenë e angazhuar prej muajsh në shumë drejtime për sigurimin e vaksinës kundër Covid-19, me qëllim të përmbushjes së obligimeve që kemi ndaj qytetarëve dhe ruajtjes së shëndetit publik të tyre. "Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë mbesin të përkushtuara që qytetarëve tanë t'u sigurojmë mbrojtje përmes vaksinimit gjithëpërfshirës kundër Covid-19. Krahas kësaj, Kosova do të marrë nga mekanizimi 'Covax' edhe 360 000 vaksina falas për

20 për qind të popullatës. Vaksina do të sigurohen për të gjitha grupet e popullatës që duhet të mbulohen me vaksinim sipas projeksioneve të IKShPK-së. Vaksina kundër Covid-19, do t'u jepet falas qytetarëve të vendit tonë", ka thënë Zemaj. Kosova ka aplikuar për sigurimin e vaksinave në "Covax" më 7 dhjetor të vitit që lamë pas. Edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se ka siguruar 500 000 vaksina nga kompania "Pfizer" dhe se një pjesë të tyre do t'ia ndajë edhe Kosovës. Kompania amerikane "Pfizer" e ka krijuar vaksinën kundër Covid-19 në bashkëpunim me kompaninë gjermane "BioNTech" dhe është thënë se efikasiteti i saj është 95 për qind. Vaksina "Pfizer/BioNTech" ka nisur të jepet për herë të parë më 8 dhjetor në Mbretërinë e Bashkuar. Ajo tani jepet në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, në ShBA, Kanada dhe disa vende të tjera. Përparësi në vaksinim gjetkë kanë punonjësit shëndetësorë dhe të moshuarit. Vaksina sugjerohet të jepet në dy doza, me një diferencë kohore prej tri javësh.

Suspendohen dy zyrtarë korrektues të Qendrës së Paraburgimit në Mitrovicë

PRISHTINË, 5 JANAR (ER)- Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) ka njoftuar se në Qendrën e Paraburgimit Mitrovicë, në shenjë pakënaqësie me vendimin e gjykatës dy të burgosur kanë dëmtuar grilën dhe dritaren dhomës, pastaj kanë arritur të ngjiten lart mbi kulmin e Qendrës së Paraburgimit Mitrovicë. "Pas shumë kërkesash, kërkesa e tyre kryesore ka qenë, se janë të pakënaqur me gjykatën, me ç'rast kanë kërkuar të bisedojnë me prokurorin, dhe pas bisedës me prokurorin në prezencë të policisë dhe

zëvendës drejtorit të përgjegjshëm të SHKK-së, Rasim Selmani, të njëjtit janë pajtuar të zbrasin poshtë", ka njoftuar SHKK-ja. Për shkak të këtij rasti, SHKK-ja ka suspenduar dy zyrtarë korrektues, deri te suspendimi është ardhur për shkak të dyshimit se zyrtarët korrektues gjatë kryerjes së detyrës zyrtare kanë shkelur procedurat e sigurisë institucionale. Lidhur me rastin, Shërbimi Korrektues i Kosovës ka iniciuar procedure disiplinore dhe ka caktuar Komisionin Hetimor të Brendshëm, i cili do të hetojë rastin në tërësi.



Kosova në vendin e dytë për çmimin më të lirë të rrymës në Evropë

Sipas Eurostat-it, Kosova zë vendin e parë në rajon dhe të dytin në Evropë për çmimin më të lirë të rrymës. Në Kosovë çmimi i energjisë elektrike është 0.0605 euro për kWh

EPOKA E RE**A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 5 JANAR - Eurostat, agjencia e BE-së për statistika, ka përditësuar të dhënat mbi çmimin e energjisë elektrike në Evropë. Sipas të dhënave të reja, Kosova zë vendin e dytë për çmimin më të lirë të rrymës në Evropë. Në Kosovë çmimi i energjisë elektrike është 0.0605 euro për kWh. Ndërkohë, vendet e tjera të rajonit kanë çmime shumë më të shtrenjta. Në rajon Kosova prin me çmimin më të lirë të rrymës derisa vendin e dytë e zë Serbia, pasuar nga Maqedonia, Shqipëria, Bullgaria dhe Mali i Zi.

Sipas një përlllogaritje, malazetët paguajnë çmime të energjisë elektrike 65 për qind më të larta se kosovarët. Çmimi më i ulët i energjisë elektrike në Evropë është regjistruar në Ukrainë, me 0.0466 euro për kWh, ndërsa më i larti në Gjermani dhe Danimarkë. Në Gjermani, çmimi për energji elektrike për konsumatorë të amvisërisë është 0.3043 euro për kWh. Gjermania pasohet nga Danimarka me 0.2833 euro për megavat dhe Belgjika me 0.2792 euro për megavat. Çmimi i rrymës në Gjermani del të jetë pesë herë më i lartë se çmimi i rrymës në Kosovë. Në përlllogaritjen e të dhënave,



Eurostat ka përfshirë edhe taksat dhe TVSh-në. Eurostat në vazhdimësi përcjell ndryshimet e çmimeve

të energjisë elektrike si brenda ashtu edhe jashtë Bashkimit Evropian dhe është përgjegjëse për publikimin e statistikave

me cilësi të lartë në mbarë Evropën që mundësojnë krahasime midis vendeve dhe rajoneve.

Gjendja e rrugëve në Kosovë është e mirë, ka pasur disa intervenime

PRISHTINË, 5 JANAR (ER) - Ministria e Infrastrukturës ka njoftuar se nga të dhënat e siguruar nga terreni për mirëmbajtje verore dhe dimërore, thotë se gjendja e rrugëve në gjithë vendin është e mirë. Sipas MI-së, në rajonin e Gjilanit ka pasur lagështira në rrugë, mirëpo është hedhur kripë sipas nevojës. Ndërsa në regjionin e Prizrenit, kryesisht rrugët ishin mirë, intervenime me kripë kishte në drejtimin Prizren - Caralevë, gjithashtu edhe në Prizreni 2 është intervenuar për shpërndarjen e kripës në rrugët Prizren - Prevallë, Zhur - Dragash - Restelicë, Dragash - Brod. Në autostradën A7, segmenti Morinë - Gjurgjicë, kishte intervenime me kripë në drejtimin Suharekë - Morinë dhe drejtimin Suharekë - Gjurgjicë. Në orët e hershme të



mëngjesit të së martës ka pasur temperatura mjaft të ulëta dhe si rrjedhojë është

bërë shpërndarja e kripës në të gjitha rrugët e regjionit Peja 1. Të gjitha rrugët janë të

kalueshme. Autoudha R6 Hani i Elezit, si dhe auto-udha A6 Konjuh-

Doganaj, si dhe regjionin e Ferizajt janë krejtësisht të lira për qarkullim. Është intervenuar në shpërndarjen e kripës në të gjitha rrugët: Prizren - Prevallë, Zhur - Dragash - Restelicë. Në aksin rrugor N9 Pejë - Kuqishtë - Bogë, në kilometrin e 18 kishte një rrëshqitje masive të dheut të hënën rreth orës 20:00. Ekipet tona kanë punuar vazhdimisht me makineri ekskavator dhe lugë ngarkuese dhe rreth orës 23:00 të hënën është bërë hapja e rrugës. "Nga kilometri i 20 e tutje ka reshje të mëdha të borës. Vazhdimisht bëhet largimi i borës dhe shpërndarja e kripës sipas nevojës. Po ashtu, në rrugët e tjera të regjionit Peja 1 ka reshje të borës e përzier me shi", ka njoftuar Ministria e Infrastrukturës.

KRU "Hidrodrini": Gjatë festave kemi intervenuar në nëntë raste

PEJË, 5 JANAR (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrodrini" ka njoftuar për nëntë raste të prishjeve që kanë rezultuar për intervenim gjatë festave e të cilat janë sanuar me kohë nga ana e ekipeve të kujdestarisë. Sipas KRU "Hidrodrini", prishjet kanë qenë kryesisht të izoluar, prej tyre pesë në

territorin e Komunës së Pejës dhe katër raste tjera më të lehta, kryesisht intervenim në puseta. "Në të gjitha rastet ekipet kujdestare të KRU 'Hidrodrini', të shtrira në komunat respektive, kanë intervenuar në kohë rekorde për t'i sanuar dëmet dhe për ta rikthyer furnizimin. Gjatë kësaj periudhe festive asnjë

rast tjetër që do ta rrezikonte në masë furnizimin me ujë nuk është raportuar. Ju rikujtojmë se për shkak të temperaturave në rënie, jeni të lutur t'i ndërmerrni masat e sigurisë ndaj orëmatësve dhe sistemit të jashtëm të gypave (nëse posedoni) në pronat tuaja", thuhet në njoftimin e kompanisë "Hidrodrini".



Hoxhaj: PDK-ja do ta krijojë fondin e përhershëm për t'i mbështetur bizneset

FUSHË-KOSOVË, 5 JANAR (ER) - Kandidati për kryeministër nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka vizituar të martën një kompani në Fushë-Kosovë, me pronar nga Presheva. Aty Hoxhaj ka treguar se PDK-ja shpejt do t'i prezantojë masat ekonomike për bizneset, edhe për bizneset që vijnë nga Presheva.

Përmes një statusi në

"Facebook", Enver Hoxhaj ka njoftuar se pjesë e planit të tij si kryeministër i ardhshëm do të jetë njohja e statusit të privilegjuar, nga ku këto biznese do të përfitojnë nga lirimi i tatimeve doganore.

Ai ka shkruar se të gjithë qytetarëve të Luginës do t'u sigurohet punësimi i barabartë me qytetarët e Kosovës në të gjitha institucionet. "Sot ditën e nisa

me një vizitë në kompaninë 'Smart Signal Signs' në Fushë-Kosovë. Biznes start-up për prodhimin e të gjitha prodhimeve të sinjalistikës, të cilat eksportohen në Belgjikë e që janë punë dore, udhëhequr nga Asdren Osmani, një ndërmarrës nga Presheva që ka zgjedhur të investojë në Kosovë dhe ia ka dalë me sukses. Kjo tregon për lidhjet që kemi ne si shtet me këtë

pjesë të kombit tonë. PDK-ja, si parti që gjithnjë ka qenë e gatshme t'i mbështesë interesat dhe vullnetin e qytetarëve të Luginës, shpejt do t'i prezantojë masat ekonomike për bizneset me pronarë nga Lugina që operojnë në Kosovë. Pjesë e planit tim, si kryeministër i ardhshëm, do të jetë njohja e statusit të privilegjuar, nga ku këto biznese do të përfitojnë

lirimin nga tatimi doganor dhe të gjithë qytetarëve të Luginës t'u sigurohet punësimi i barabartë me qytetarët e Kosovës në të gjitha institucionet e vendit. Qeveria e ardhshme e PDK-së do ta krijojë Fondin e Përhershëm për t'i mbështetur të gjitha aktivitetet ekonomike, kulturore dhe arsimore në Luginë të Preshevës", ka shkruar Hoxhaj.



Hotelierët e Kosovës: Sa më parë të hiqen kufizimet



PRISHTINË, 5 JANAR (ER) - Oda e Hotelierisë dhe Turizmit e Kosovës me anë të një letre publike drejtuar institucioneve të Kosovës, ka kërkuar që të hiqen kufizimet e vendosura si masë parandaluese ndaj pandemisë Covid-19. Sipas tyre, brenda një viti të hiqet tatimi për bizneset që kanë qenë të mbyllura. "Sa më parë që është e mundur të hiqen kufizimet sepse nuk kanë fare kuptim në këtë mënyrë që janë duke u

zbatuar, ndërkohë kërkojmë që të dënohen apo të mbyllen të gjitha ato biznese të cilat nuk i respektojnë masat e mos ta pësojnë të gjithë; kërkojmë në mënyrë kategorike të respektohet interpretimi i lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë për hotelet dhe për mysafirët sepse ekzistojnë dëshmi që nuk po përfilllet. Nga data 1 janar deri më 31 dhjetor 2020 urgjentisht të hiqet tatimi për të gjitha subjektet të cilat kanë qenë të

mbyllura dhe nuk kanë punuar me të gjitha kapacitetet e plota. Shpërndarja e mjeteve nga Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike t'u dedikohet veprimtarive më të atakuara nga pandemia Covid-19. Pas stopimit të kredive nga ana e qeverisë, kërkojmë që pas fillimit të pagesave të hiqet interesi bankar që nga fillimi i periudhës së pandemisë", thuhet në njoftimin e Odës së Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës.



Japonia mbetet e përkushtuar për ta ndihmuar Kosovën në projekte të ndryshme

MITROVICË, 5 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, së bashku me nënkryetarin Faruk Mujka kanë pritur në takim të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Japonisë në Kosovë, Mitsunori Ogasawara, si dhe Arbër Myftari nga Zyra Ndërlidhëse e Japonisë në Prishtinë.

Kryetari Bahtiri, pasi i ka uruar mirëseardhje Ogasawaras, e ka falënderuar për ndihmën e vazhdueshme që Japonia ka dhënë për Kosovën dhe

Mitrovicën. Bahtiri i ka thënë ambasadorit japonez, Ogasawara, se ai ka më shumë se 17 vjet që si biznesmen jeton dhe punon në Holandë dhe ka kontakte afariste me kompanitë e ndryshme e të rëndësishme të shtetit të tij.

Ndërkaq i ngarkuari me punë në Ambasadën e Japonisë, Mitsunori Ogasawara, ka thënë se është i lumtur që vizitën e tij të parë për këtë vit po e realizon pikërisht në Mitrovicë, duke potencuar se qëllimi i këtij takimi është që të njoftohet

lidhur me gjendjen e Komunës së Mitrovicës gjatë përbaljes me pandeminë Covid-19 si dhe mundësinë që Qeveria e Japonisë ta ndihmojë zhvillimin e sektorit të shëndetësisë dhe ekonomisë.

Gjithashtu, ai i ka thënë Bahtirit se Japonia mbetet e përkushtuar për ta mbështetur Kosovën si dhe do të angazhohet për të ardhmen që të sigurojë grante dhe investitorë për realizimin e projekteve të ndryshme, me theks të veçantë për qytetin e Mitrovicës.



Ish-gjenerali i UÇK-së viziton kryetarin e Drenasit



DRENAS, 5 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur të martën në takim ish-gjeneralin e UÇK-së, Sylejman Selimin. "Ditën e parë të punës, në takimin e parë të këtij viti të mbarë, prita në takim një nga bijtë më të çmuar të luftës dhe paqes, ish-gjeneralin

Sylejman Selimi. Krenar me miqësinë tënde miku im, jeta na ka përpjekur shumë herë në sfidat e rënda dhe të përbashkëta për liri, gjatë shtetndërtimit, gjithmonë në shërbim të kauzave madhore", ka shkruar Lladrovci në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka theksuar se lartësimi i atdheut është rrugë e gjatë dhe për atdhetarin, është mision. "Këtë mision ua kemi borxh të rënëve dhe gjeneratave që tash kontribuojnë për atdheun me përgjegjësi në krye të detyrës", ka shkruar Lladrovci.

Formohet komisioni për verifikimin e dëmeve pas vërshimeve në Deçan

Deçan, 5 janar (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka mbajtur takimin konsultativ të Këshillit të Drejtorëve, ku është diskutuar për çështje të ndryshme. Gjatë këtij takimi është diskutuar edhe për situatën e krijuar pas reshjeve të shiut dhe erërave të forta në fund të vitit 2020 që shkaktuan edhe dëme në rrjetin elektrik dhe vërshime nga uji në disa fshatra të Komunës së Deçanit, për çka u bë me dije se është formuar një komision për verifikim të dëmeve dhe do të

dalë me një raport të hollësishëm lidhur me situatën në terren.

Po në këtë takim është diskutuar për menaxhimin e situatës për parandalimin e Covid-19, ku Komuna e Deçanit aktualisht ka vetëm 77 raste aktive me Covid-19 dhe situata është nën kontroll. Gjithashtu, është diskutuar edhe për një sërë temash me rëndësi për Komunën e Deçanit dhe angazhimet e shumta që e presin në realizimin e projekteve për vitin 2021.



Haziri: Viti 2021 në Gjilan do të jetë vit i Kadri Zekës dhe vëllezërve Gërvalla

Gjilan, 5 janar (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se viti 2021 u dedikohet heronjve të kombit, Kadri Zeka dhe Jusuf e Bardhosh Gërvalla. Ai ka bërë me dije se më 15 qershor në Gjilan do të vendoset shtatorja e heroit të kombit Kadri Zeka. "2021 është vit i Kadri Zekës dhe vëllezërve Gërvalla, Jusufit dhe Bardhoshit. Ne planifikojmë që më 15 qershor të zbres në bronz një nga kryengritësit më të mëdhenj për lirinë e shqiptarëve, heroi Kadri Zeka për t'i bërë roje lirisë sonë", ka thënë Haziri në konferencën e parë për media të

vitit 2021.

Duke folur për përgatitjet për manifestimin kulturor dhe mbarëkombëtar "Flaka e Janarit", Haziri ka thënë se sivjet ky manifestim do të zhvillohet në përputhje me rregullat e pandemisë, me numër të kufizuar të pjesëmarrësve. "Flaka e janarit për 30 vjet ka qenë sinonim i respektimit të veprave të dëshmorëve dhe heronjve, të cilët vendit i dhanë gjakun me sakrificë, dijen e mbështetjen e tyre për këto ditë të bardha të lirisë. Ky është muaji i Skënderbeut, Ibrahim Rugovës, Kadri Zekës, Jusuf dhe Bardhosh

Gërvallës, Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës, Reshat Ymerit dhe shumë burrave e grave që vendit i dhanë më të shtrenjtën", ka thënë ai, duke shtuar se ky manifestim mbarëkombëtar do të mbahet në kushte pandemie. Nuk mund ta realizojmë ndryshe.

Kreu i Gjilanit ka pohuar se të gjithë drejtorët komunalë e përgjegjës të zyrave janë autorizuar që t'i realizojnë me dinamikë planet e punës për tremujorin e parë, për t'i vazhduar investimet publike sipas ligjeve në fuqi.

Në këtë konferencë për media ka



folur edhe drejtoresha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Deniza Limanai, e cila ka bërë me dije se gjithçka po shkon në

mënyrën më të mirë, në mënyrë që ky 30-vjetor të themelimit të "Flakës..." të jetë sa më madhështor.

SHPËRFAQJA E (DE)FEKTEVE TË VAKSINËS NË KOSOVË

Zërat skeptikë dhe kritikë në media dhe në shoqërinë e Kosovës thonë se vendi ynë ende nuk ka një plan konkret për furnizim me vaksinën Covid-19 dhe për rrjedhë ekziston frika që Kosova do të furnizohet shumë vonë me këto vakcina. Me vetë faktin se të gjitha shtetet e tjera kanë bërë marrëveshje dhe kanë paguar për vaksinë, kjo tregon se Kosova ende nuk ka një plan konkret në këtë drejtim



Nga Mehmet PRISHTINA

Bashkimi Evropian filloi vaksinimin me vakcina "Pfizer/BioNTech" më 27 dhjetor, ndërkohë që ushtruesi i detyrës i drejtorit të ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, për mediat ka deklaruar se, edhe pse nuk ka një datë të saktë, vakcina në Kosovë pritet të jetë e disponueshme në muajt e parë të vitit 2021.

Tashmë është bërë me dije se vendet e pasura do të kenë qasje në vaksinat kundër koronavirusit më herët se të tjerat, ndërsa vendet e fundit ku pritet të jenë në dispozicion vaksinat anti-Covid do të jenë

kryesisht ato të Ballkanit, ku bën pjesë edhe Kosova. Sipas një raporti të publikuar në "The Economist", Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pjesa më e madhe e Evropës dhe Japonisë, renditen të parat në listën e zbatimit të kësaj zgjidhjeje të supozuar për t'i dhënë fund pandemisë.

Zyrtarët e Kosovës e pranojnë se ka një garë mes shteteve të mëdha dhe të vogla për sigurimin e vaksinës kundër Covid-19, por ata shpresojnë se Kosova nuk do të mbetet jashtë saj.

Specialistët kanë sqaruar se vaksinat aktuale nga "Pfizer" po aplikohen si urgjencë, ndonëse ende nuk është konfirmuar se për sa kohë imunizohen, ose nëse marrësi mund t'i infektojë të tjerët apo jo.

Ajo çfarë mbeti pa u sqaruar deri në fund ishte depërtimi i vaksinave nga Serbia në disa enklava serbe në Kosovë.

Dërgesa e pare ishte rreth 5 000 doza. Sipas zyrtarëve të Beogradit, Serbia është ndër vendet e para që do ta marrë vaksinën sepse ishte një nga pesë shtetet e para në botë që nënshkroi një kontratë me "Pfizer"-in dhe qysh më 15 dhjetor Serbia kishte porositur 340 000 doza të vaksinës nga kompanitë "Pfizer" dhe "BioNTech". Në Serbi ka depërtuar edhe vakcina ruse "Sputnik V" e cila ende po testohet.

Lidhur me këtë çështje, si edhe në raste të ngjashme më herët, institucionet e Kosovës u gjetën të papërgatitura dhe kanë paralajmëruar se do ta hetojnë mënyrën se si kanë depërtuar këto vakcina në territorin e vendit tonë. Ajo çfarë nuk kërkon ndonjë sqarim shtesë është fakti se institucionet e Kosovës, megjithatë, nuk po e shtrijnë sovranitetin shtetëror e kushtetues në gjithë territorin dhe kjo flet për plagët e hapura që pritet të jenë preokupim i së ardhmes.

Vendet e rajonit tashmë kanë nënshkruar kontrata me kompanitë farmaceutike. Përderisa Serbia ka bërë porositë e para për vaksinën kundër Covid-19, të njëjtën gjë e ka bërë edhe Maqedonia e Veriut, e cila ka nënshkruar një kontratë me kompaninë "AstraZeneca" për 800 000 doza të vaksinës, të cilat pritet

të arrijnë në fillim të vitit 2021. Në anën tjetër, Kosova shënon ngecje në këtë drejtim. Ajo pret që të marrë vakcina për 20 për qind të popullatës nga programi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, COVAX, ndërkaq pjesën tjetër do ta blejë vetë.

Siç bëhet me dije, programi COVAX, sipas një hulumtimi të "Reuters"-it, deri më tani ka krijuar marrëveshje furnizimi jodetyruese me kompanitë "AstraZeneca", "Novavax" dhe "Sanofi" për një total të rreth 400 milionë vaksinave, me mundësi të porositjes së qindra miliona dozave shtesë. Mirëpo, ndërkohë janë paraqitur probleme shtesë, për arsye se të tri kompanitë janë përballur me vonesa në testimet e tyre, çka mund ta shtyjë procesin e miratimit të vaksinave nga rregullatorët deri në gjysmën e dytë të vitit 2021 apo edhe më gjatë.

Kjo është edhe arsyeja që në Kosovë gjithnjë e më tepër dëgjohej zëra skeptikë dhe kritikë në adresë të institucioneve shëndetësore, përfshirë edhe Ministrinë e Shëndetësisë, aq më tepër kur iniciativa e OBSH-së për shpërndarjen e vaksinave për vendet e varfra, ende nuk ka marrë zotimin e vendeve të pasura që ato t'i ndajnë vaksinat.

Mospërballimi financiar i shteteve të varfra për t'i

siguruar vaksinat ka detyruar BE-në të ndajë 500 milionë euro nga buxheti i saj dhe i shteteve anëtare për të siguruar mbi 1 miliard doza vaksinash përmes programit COVOX. Nga ky buxhet, Kosova do të përfitojë 20 për qind të vaksinave që do t'i marrë falas.

Zërat kritikë në media dhe në shoqërinë e Kosovës thonë se vendi ynë ende nuk ka një plan konkret për furnizim me vaksinën Covid-19 dhe për rrjedhë ekziston frika që Kosova do të furnizohet shumë vonë me këto vakcina. Me vetë faktin se të gjitha shtetet e tjera kanë bërë marrëveshje dhe kanë paguar për vaksinë, kjo tregon se Kosova ende nuk ka një plan konkret në këtë drejtim.

Si duket, vakcina anti-Covid që pritet të përdoret, përpos efektit imunizues të njerëzit, po shpërfaq edhe një (d)efekt tjetër, por në drejtim të kundërt. Ajo po dëshmon se sa të brishta janë shtetet, përfshirë edhe Kosovën, të cilat, përpos pafuqisë financiare, po nxjerrin në sipërfaqe edhe mungesën e kapaciteteve për të hartuar strategji më efikase që lidhen me situata të jashtëzakonshme, siç është rasti me pandeminë aktuale.

A do të mjaftojnë këto dobësi për të nxjerrë mësim në të ardhmen?



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Thaqi: Ballkani rrëmben titullin ose Kupën

Armend Thaqi është ndër lojtarët e rrallë vendor që ka mbrojtur ngjyrat e Përfaqësueses së Kosovës në futboll. Ai është zgjedhur lojtari i vitit në Superligë dhe synimin e radhës ka fitimin e një trofeu me Ballkanin dhe daljen në garat evropiane. “Synojmë ta sigurojmë pjesëmarrjen në garat evropiane, por duke e parë ecurinë deri tash, jemi në garë për trofe dhe do të luftojmë deri në fund që ta arrijmë ndonjërin nga trofetë pse jo”, ka thënë Thaqi



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 JANAR - Armend Thaqi është shpallur futbollisti i vitit në Superligën e Kosovës në futboll. Mbrojtësi që tash mbron ngjyrat e Ballkanit ka thënë se është shumë i lumtur që suksesi shumëvjeçar është shpërblyer në fund. “Është një çmim dhe vlerësim që më kanë bërë të ndihem mirë dhe krenar, pasi është një shpërblim për punën disavjeçare. Normalisht se më jep motiv edhe më të madh të punoj dhe të arrij suksese të reja”, ka thënë Thaqi për “Epokën e re”. Thaqi edicionin e kaluar me Prishtinën është shpallur fitues i Kupës, më pas mori ftesë nga Përfaqësuesja A, derisa me Ballkanin e përfundoi sezonin në vendin e dytë dhe në fund e fitoi edhe çmimin e më të mirit në futbollin e Kosovës. Ai është shprehur se gjithë këto suksese e bëjnë edhe më të fortë për të vazhduar me

paraqitje dhe për t'i ndihmuar ekipit që të arrijë suksese. “Nuk ka ndjenjë më të mirë se ta përfaqësosh vendin ku je rritur dhe ta veshësh fanellën me simbolet e shtetit tënd. Synimi im është të vazhdoj me këtë ritëm të jap më të mirën nga vetja dhe ta ndihmoj ekipin për t'i arritur objektivat”, ka shtuar Thaqi.

Skuadra nga Suhareka e përfundoi sezonin vjeshtor në vendin e dytë me tri pikë më pak se Drita, por Thaqi beson se ky do të jetë një sezon i suksesshëm për skuadrën e Ballkanit. “Synojmë ta sigurojmë pjesëmarrjen në garat evropiane, por duke e parë ecurinë deri tash jemi në garë për trofe dhe do të luftojmë deri në fund që të arrijmë ndonjërin nga trofetë”, ka thënë Thaqi.

Në shtabin teknik të skuadrës së Ballkanit është bërë ndryshim duke u zëvendësuar Ismet Munishi me Bledi Shkëmbin, kurse mbrojtësi e ka falënderuar ish-trajnerin për punën e

bërë dhe trajnerit të ri i ka uruar mirëseardhje. “Për ndryshimet e shtabit teknik është dikush tjetër që vendos dhe nuk kam dëshirë të komentoj shumë. Por nuk mundem pa e falënderuar trajnerin Ismet për të gjithë kontributin që ka dhënë për klubin dhe për ne. Po ashtu i uroj shumë suksese në të ardhmen. Ndërsa trajnerit Shkëmbi i kemi uruar mirëseardhje dhe jemi në shërbim të tij për gjithçka që i nevojitet dhe shpresojmë të na ecë mbarë dhe në fund të jemi të gëzuar”, ka deklaruar ish-kapiteni i Prishtinës.

Ballkani sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e dytë në tabelë me 38 pikë të grumbulluara, tri më pak se Drita që mban pozitën e parë dhe gjashtë më shumë se Prishtina që pozicionohet e treta në renditjen tabelore. Klubi që drejtohej nga Ismet Munishi në sezonin vjeshtor nga 18 ndeshje regjistroi 12 fitore, 2 barazime dhe 4 humbje.

SHKURT

Prishtina sot fillon përgatitjet

FC Prishtina sot (e mërkurë) do t'i fillojë përgatitjet për sezonin pranveror në elitën e futbollit të Kosovës. “Pas pushimit që nga ndeshja e fundit me Dritën, futbollistët ‘bardhekaltër’ të mërkurën u rikthehen përgatitjeve dimërore. Seanca stërvitore nis nga ora 12:30 në fushën ndihmëse të Prishtinës”, thuhet në njoftimin e klubit kryeqytetas.

“Carteri” ndahet me KB Bashkimi

KB Bashkimi ka njoftuar se “Shaq Carter” nuk është më pjesë e ekipit nga Prizreni. Në një njoftim në faqen zyrtare në “Facebook”, është bërë me dije se ai e ka shkëputur kontratën me skuadrën nga Superliga e Kosovës në basketboll. “Qendra amerikane ‘Shaq Carter’ ka shkëputur kontratën me Bashkimin pas marrëveshjes së dyanshme me drejtuesit e klubit. Falënderojmë basketbollistin për kontributin e tij të deritashëm dhe i urojmë suksese në karrierën e mëtejme”, thuhet në njoftimin e klubit.

Munishi: Nuk e di nëse Shkëmbi ka drejtuar ‘Ferrari’, por të ketë kujdes kthesat

Trajneri Ismet Munishi u shkarkua nga drejtimi i skuadrës Ballkani, vendin e të cilit e ka marrë tashmë Bledi Shkëmbi. Munishi ka thënë se Shkëmbi duhet ta shijojë “Ferrarin”, por të ketë kujdes në kthesa. Ndërsa për Orges Shehun, trajnerin që ishte afër Ballkanit, deklaroi se e respekton shumë. “Me Shehin do ta hamë drekën, e respektoj shumë. Shkëmbit i dëshiroj suksese dhe punë të mbarë. Nuk e di se a ka drejtuar ‘Ferrari’ më herët, le ta shijojë drejtimin e tij, por le të ketë kujdes nga kthesat”, ka deklaruar Munishi për “Zeri.info”.

Galatasaray interesohet për Muriqin

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, mund të rikthehet në Turqi. Është skuadra e Galatasarayt që ka shfaqur interesim për sulmuesin shtatlartë, i cili në të kaluarën ka shkëlqyer në Superligën turke me fanellën e Fenerbahçes. Lajmi është bërë me dije nga mediumi turk “Fotosport.com”. Sulmuesi nga Prizreni ishte transferuar në Lazio verën e kaluar nga Fenerbahçe për 18 milionë euro, por ende nuk ka arritur të dëshmojë në skuadrën italiane.

Llapi transferon ish-portierin e Parmës

PODUJEVË, 5 JANAR - Skuadra e Llapit e ka prezantuar përforcimin me të ri, Marijan Coric. Bëhet fjalë për një futbollist të dëshmuar që në të kaluarën ishte pjesë e Parmës në Itali. Ai ka nënshkruar

kontratë gjashtë mujore me klubin e drejtuar nga Tahir Batatina. "Përforcimi më i ri i Llapit është portieri kroat i gjatë 204 cm, Marijan Coric. Coric është 25-vjeçar dhe tek Llapi vije nga skuadra SV TEC Tiel në

Holandë. Coric karrierën e ka filluar tek NK Istra 1961, ekip në të cilin kaloi kategoritë e reja zinxhimore deri tek U19, ku më pas ishte i huazuar tek skuadra e famshme italiane, Parma së pari në U19 e më pas edhe në

skuadrën e parë", thuhet në njoftimin e Llapit. 25-vjeçari ka bërë karrierë edhe në skuadrën tjetër italiane, Spezia Calcio si dhe në NK Kustosija Zagreb, NK Uljanike në Kroaci dhe FK Palanga në Lituani.



Dy përballje interesante në basketboll

PRISHTINË, 5 JANAR - Në mesjavë do të zhvillohet xhiroja e 13-të në Superligën e Kosovës në basketboll. Takim interesant shihet ai ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Pejës. Therandasiit kanë shtatë fitore dhe pesë humbje në këtë edicion, kurse pejanët tetë fitore dhe katër humbje. Fakt interesant është edhe ballafaqimi i trajnerëve nga Turqia, Fatih Emre Gezer i Yllit dhe Shemsettin Bash i Pejës.

Ndërkohë, të mërkurën përballen edhe dy skuadrat me traditë, Vëllaznimi dhe Sigal Prishtina, por që nuk janë në pozita të dëshiruara. Kuqezinjët kanë katër fitore dhe tetë humbje, kurse "bardhekaltrit"



tri fitore dhe nëntë humbje. Të enjten zhvillohet derbi i qytetit ndërmjet Bashkimit dhe Ponte Prizrenit, dy skuadra që janë në formë shumë të mirë. Bashkimi ka gjashtë fitore dhe gjashtë humbje, kurse Ponte Prizreni nëntë fitore dhe tri humbje.

Trepça që ka bërë disa ndryshime në skuadër do të ndeshet me Rahovecin, që ka synime të mëdha në këtë edicion. Mitrovicasit kanë dy fitore dhe dhjetë humbje, kurse Vreshtarët nëntë fitore dhe tri humbje.

SUPERLIGA - Java 13

Të mërkurën takohen:

15:00 Golden Eagle Ylli - Peja

15:00 Vëllaznimi - Sigal Prishtina

Të enjten takohen:

15:00 Trepça - Rahoveci

15:00 Bashkimi - Ponte Prizreni

Golden State regjistron edhe një fitore, Dallasi mposhti Houstonin

San Francisco, 5 janar - Moment i artë për Golden State Warriorsin që mori fitoren e katërt në pesë ndeshjet e fundit në NBA. Pak nga pak Warriorsi po rikthehet si para dy vjetëve. Në San Francisco, Golden State mposhti me shifrat e thella 137-106, Sacramento Kings falë një super Stephen Curry që këtë herë shkëlqeu me 30 pikë 9 rebounde dhe 8 asistime. Me një Luka Donqiq në formë spektakolare, Dallas Mavericks u rikthye te fitorja në NBA duke triumfuar në derbin teksan përballë Houston Rockets brenda në "Toyota Center" me rezultatin 113-100. Meritat absolute në këtë sukses të Dallasit shkojnë për talentin slloven Donqiq i cili koleksionoi një triple-double duke e mbyllur ndeshjen me 33 pikë, 16 rebounde dhe 11 asistime, raporton "SS". Shumë të lehtë e pati Miami Heati përballë Oklahoma City Thunderit ndeshje të cilën e



fitoi me rezultati 118-90. Për skuadrën nga Florida ky ishte sukcesi i 3-të në 6 takime, ndërkohë që Oklahoma pësoi humbjen e 4-t. Fitore e merituar për Boston Celticsin në transfertën kanadeze ndaj Toronto Raptorsit me shifrat 126-114. Më i miri mbi parket për Celticsit ishte Jason Tatum

me 40 pikë. Buzëqesh edhe Milwaukee Bucksit që mposhti me rezultatin 125-115 Detroit Pistonsin në një ndeshje ku për Bucksin spikati i përhershmi Giannis Antetokounmpo me 43 pikë, 9 rebounde dhe 4 asistime. Për Milwaukeeen kjo ishte fitorja e katër në shtatë takime.

SHKURT

Ramosi, Perezit: Do të shkoj te PSG-ja me Messin

Real Madridi duket se ka hequr dorë nga rinovimi me Sergio Ramos teksa tashmë ka pranuar faktin se mund ta humbasë. Thashethemet e fundit nga Spanja sugjerojnë divorcin e bujshëm në fund të sezonit, me mbrojtësin e gatshëm që të bashkohet me Paris Saint-Germainin së bashku me Lionel Messin. Detajet janë zbuluar në programin e njohur "El Chiringuito", që ka informacione të sakta për klubin madrilen. Të mërkurën e kaluar kishte një takim mes Ramos dhe Perezit, teksa mësohet se mbrojtësi i ka thënë: "Unë nuk do ta pranoj propozimin që më ke bërë dhe do të filloj t'i dëgjoj ofertat që do të më vijnë. PSG? Me mua dhe Messin ata do të bëjnë një ekip të shkëlqyer". Fiorentina ndërkohë mësohet se i është përgjigjur: "Nëse do të vijë një ofertë e mirë, ne do të kuptojmë". Reali, në fakt, i ka propozuar një kontratë të re me 10 për qind ulje nga aktualja ku përfiton 15 milionë euro në sezon.

Ish-mbrojtësi i Anglisë: Kane duhet të shkojë në Real

Ish-mbrojtësi anglez Jonathan Woodgate ka thënë se sulmuesi Harry Kane duhet t'i bashkohet skuadrës Real Madridi në mënyrë që ta arrijë në nivelin e yjeve si Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo. "Nëse ai dëshiron të fitojë trofe dhe të futet në piedestal tjetër si ai i Messit, Ronaldos, ai duhet të shkojë", ka thënë Woodgate. Kujtojmë se futbollisti 27-vjeçar është pjesë e skuadrës Tottenham dhe kapiten i Kombëtares së Anglisë.

Giroudi ia mbyll derën Juventusit

Sulmuesi Olivier Giroud nuk është i interesuar të transferohet te Juventusit, pasi dëshiron që të jetë pjesë e Chelsea dhe për një kohë. "Karrierën time të mbetur në kohë të shkurtër e shoh te Chelsea. Dua të jem i qetë dhe të fokusohem në fushë. Jam duke i afruar fundit të kontratës në qershorin e ardhshëm, edhe pse kam edhe një vit shtesë me mundësi. Do të shohim në fund të vitit", ka thënë Giroud. "Por, kam ambicie të fitojë trofe me Chelsea këtë sezon sepse kam shpresa në kualitetin e skuadrës", ka shtuar ai.

Dy të infektuar me Covid te Barça

Skuadra e Barcelonës ka konfirmuar se dy anëtarë të stafit teknik kanë rezultuar pozitiv për koronavirus në testet e kryera së fundmi para ndeshjes me Athletic Bilbao. Si pasojë klubi ka vendosur të testojë edhe një herë të gjithë stafin dhe ekipin dhe deri atëherë skuadra nuk do të stërvitet për t'i shmangur kontaktet me të infektuarit e mundshëm. "Pas testeve PCR të kryera, dy anëtarë të stafit të ekipit të parë të futbollit kanë dalë pozitivë në testet e kryera për Covid-19. Klubi ka informuar autoritetet përkatëse të sportit dhe shëndetit. Si rezultat, seanca e planifikuar për të martën në 11:00 të mëngjesit është shtyrë", thuhet në deklaratën e Barçës.

Tirana merr si huazim Seferin

Ekipi i Tiranës ka zyrtarizuar afrimin e parë në merkaton e janarit dhe bëhet fjalë për Taulant Seferin. Seferi, i shumëpërmendur për kalimin e tij te Shkëndija e Tetovës, tashmë e gjen veten nën ngjyrat bardheblu. Kanë qenë kryeqytetasit që kanë njoftuar se është mbyllur me sukses marrëveshja me Young Boys për ta huazuar sulmuesin Seferi. "Mirë se vjen Taulant Sulejmanov (Taulant Seferi)! Klubi i Futbollit Tirana njofton afrimin e parë të merkatos së janarit. KF Tirana njofton arritjen e marrëveshjes me klubin e madh evropian Young Boys për huazimin e sulmuesit Taulant Seferi. Pas bisedimeve të orëve të vona mes dy presidencave u arrit bashkëpunimi për të pasur në organikën e ekipit tonë 24-vjeçarin. Seferi është prej kohësh pjesë e klubit zviceran dhe gjithashtu lojtar i kombëtares shqiptare të futbollit ku ka bërë paraqitje tejet dinjitoze. Klubi i uron suksese me fanellën bardheblu", shkruan ekipi i Tiranës.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzekjez të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti



ÇMIMI: 5.99 €

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLOWSKI



AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.



4.99 €

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Dior-AI” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810188385 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Dior-AI” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 810188385, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Dior-AI” L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 810188385 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr.13/01
Më: 05/01/2021
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativin për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

KONKURS- plotësues

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafilior, fillor të mesëm të ulët të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2020/2021.

SHFMU "Samidin Emini" Kuk

1. Një mësimdhënës për Gjuhë Gjermane (10 orë)

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.), Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës), Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj, Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar, Certifikata që nuk jeni nën hetime, Ekstrati i lindjes, Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë: 05.01.2021
Dragash

Drejtori i DKA-së
MSc. Vloran Cenaj

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► “Arriti Term” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810000878.

► Premtim Beqiraj B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811300657.

► Arsim Daftallati shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Albert Jasharaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Smel Vorfaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Vëllezërit Frashëri " Pllanej.

► Driton Vorfaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Vëllezërit Frashëri " Pllanej.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

